

BRIF MUJOR

gusht 2016

Monitorimi i qeverisjes të rritjes në fushën e drejtësisë nga Strategjia për Evropën Juglindore 2020 (JuDGMeNT)

Pasqyra mujore publikohet në kuadër të Projektit “Monitorimi i qeverisjes të rritjes në fushën e drejtësisë nga Strategjia për EIL 2020 (JuDGMeNT)“, të cilin e zbaton Instituti për Politikë Evropiane, me mbështetje financiare të Këshillit Rajonal për Bashkëpunim. Qëllimi kryesor i Projektit është vendosja e mekanizmit të strukturuar nga organizatat qytetare për monitorimin e përmbushjes së masave/instrumenteve/prioriteteve nga dimensionin *Drejtësi*, konform Strategjisë së EIL 2020. Këto masa janë:

P.1. Përmirësimi i efikasitetit dhe kompetencës: pasqyra e cilësisë, efikasitetit dhe kompetencës të gjyqtarëve dhe gjykatave;

P.2. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor sa i përket qasjes së lirë deri te informacionet, zbatimi i ekzekutimeve ndërkufitare dhe procedurave ndërkufitare sa i përket falimentimit, transferimit dhe bashkimit;

P.3. Mbështetje të zgjidhjes alternative të kontesteve (ZAK): Inkorporimi ose përmirësimi i kornizës ligjore për ZAK dhe ofrimi i bashkëpunimit përkatës juridik dhe institucional me sistemin gjyqësor dhe me sistemin e zbatimit.

Për më shumë informacione për Projektin vizitoni linkun në vijim:
http://www.epi.org.mk/newsDetail_mk.php?nwsid=131.

Cilësia, kompetenca dhe efikasiteti i gjyqtarëve dhe gjyqësorit

Këshilli Gjyqësor i RM në muajin gusht të vitit 2016 mbajti vetëm një mbledhje në të cilën mori vendime për shpalljen e konkurseve për zgjedhjen e 28 gjyqtarëve në një pjesë të gjykatave themelore dhe të apelit, në Gjykatën Administrative, në Gjykatën e Lartë Administrative dhe në Gjykatën Supreme të RM.¹

Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev” më datë 30.08.2016 shpalli konkurs për pranimin e dëgjuesve të trajnimit fillestar, me qëllim të plotësimit të numrit të nevojshëm të prokurorëve publikë, konform ndryshimeve dhe plotësimeve ligjore nga muaji dhjetor i vitit 2015.² Në këtë konkurs mund të paraqiteshin juristë të diplomuar me kushte të ndryshuara për pranim, përkatësisht me notë mesatare nga studimet me më së paku 7,0 të cilët kanë stazh pune prej më së paku 5 vjet në punë juridike pas provimit të dhënë të jurisprudencës në gjykatë ose në prokurori publike si nëpunës gjyqësor ose si nëpunës i prokurorisë publike apo si avokat, ndërsa trajnimi do të mbahet në një fazë, përkatësisht trajnim nëntëmujor teorik.³

¹ Komunikata nga mbledhja e mbajtur e Këshillit Gjyqësor të RM është e aksesshme në linkun si vijon:
<http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=449>.

² “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.163 30.08.2016

³ Ibid.



Në ndërkohë, nuk ka informacione të aksesshme sa i përket procedurës së përzgjedhjes së gjeneratës së gjashtë të dëgjuesve të trajnimit fillestar, ku akoma nuk është krijuar rank lista përfundimtare për shkak të procedurave ankimore të cilat zhvillohen para Gjykatës Administrative dhe Gjykatës së Lartë Administrative.

Gjatë muajit gusht, mes tjerash, është përpiluar edhe plani i aktiviteteve për trajnimin e vazhdueshëm vullnetar për nëpunësit gjyqësorë dhe të prokurorive publike⁴, si dhe plani i aktiviteteve për trajnimin e detyrueshëm të vazhdueshëm për gjyqtarë, prokurorë publikë, kryetarë të gjykatave dhe prokurorë publikë të prokurorive publike⁵ dhe që të dy trajnimet brenda periudhës shtator – dhjetor të vitit 2016.

Në periudhën nga muaji maj i vitit 2016 deri në shtator të vitit 2016 administrata gjyqësore, e pakënaqur nga Ligji për shërbimin gjyqësor⁶, u hodh në grevë përmes bllokimit të punës së gjykatave. Revolta e administratës gjyqësore u intensivikua pas Vendimit për rritjen e pagave të gjyqtarëve, prokurorëve dhe nëpunësve të prokurorive publike. Gjatë kohës së grevës, një pjesë e gjykatave punonin me kapacitete minimale, zhvilloheshin vetëm procedurat për masë të përkohshme dhe procedurat me elemente të huaja, ndërsa për mospasje të kushteve, si dhe për shkak të intensitetit të grevës, paditë dhe shkresat thuaja se asnjëherë nuk u pranuan. Nga 15 korriku dhe gjatë muajit gusht sindikata e pezulloi grevën, edhe pse nuk arritën marrëveshje.

Bashkëpunimi gjyqësor lidhur me qasjen e lirë deri te informacionet, zbatimin e ekzekutimit ndërkufitar dhe procedurën ndërkufitare sa i përket falimentimit, transferimit dhe bashkimit

Duke filluar nga muaji qershor i vitit 2016 u aktualizua rasti i tentativës për transferimin e SHA “Makpetroll” nga ana e “Balkan Petroleum Holding Limited”. Kompania qipriote, përmes shpalljes në media, e publikoi synimin për transferimin e “Makpetroll”. Mediat në mënyrë aktive i ndiqnin ngjarjet në lidhje me këtë situatë dhe raportonin se kompania është themeluar para 12 ditësh, në Londër, me seli në Qipro. Mediat raportuan se ajo kompani ka dy të punësuar dhe është themeluar me kapital themeltar prej 1.000 euro. Për aksionet e “Makpetrollit” të cilat në bursë shiteshin me çmim prej 17.000 denarë, kompania ofron 25.908 denarë. Këshilli Drejtues i “Makpetrollit” e shqyrtoi shkresën e “Balkan Petroleum Holding Limited” dhe vendosi se për të njëjtën nuk mund të veprohet.

Qëndrim të njëjtë kishte edhe Bursa Maqedonase, të cilët theksuan se edhe ata kanë pranuar shkresë me përmbajtjen e njëjtë. Me shkresën e “Balkan Petroleum Holding Limited” nuk është dërguar autorizim përkatës në bazë të të cilit do të verifikohet legjitimiteti i personit të autorizuar që të paraqitet në emër të shoqërisë dhe për këtë shkak Bursa Maqedonase këtë lëndë nuk e trajtoi.

Vlera e kontabilitetit të një aksioni është 30.250 denarë. Sipas çmimit të ofruar prej 25.908 denarë kjo nënkupton se “Balkan Petroleum Holding Limited” duhet të sigurojë garanci prej rreth 47 milionë euro.

⁴ <http://www.jpacademy.gov.mk/upload/KATALOZI/1%20plan%20za%20obuki.pdf>

⁵ <http://www.jpacademy.gov.mk/upload/KATALOZI/1%20plan%20za%20obuki.pdf>

⁶ Kërkesat kryesore kanë të bëjnë me rritjen e shtojcave të pagës për 35 për qind dhe kthimin e orarit të vjetër të punës prej orës 07:30 deri në orën 15:30.



Zgjidhja alternative e kontesteve

Gjatë muajit gusht nuk janë vërejtur aktivitete të mëdha në fushën e ZAK – Ndërmjetësimit. Në muajt e verës, duke filluar nga 15 korriku dhe deri në 15 gusht, gjyqtarët nuk caktojnë seanca gjyqësore, përveç atyre urgjente dhe të paprolongueshme sipas Ligjit për gjykata, kështu që edhe interesimi tek palët është reduktuar sa i përket paraqitjes së kërkesave për zbatimin e procedurave të ndërmjetësimit.

Në lidhje me numrin e rasteve të evidentuara të ndërmjetësimit në Ministrinë e Drejtësisë, gjatë muajit gusht, në Regjistrin për evidentimin e procedurave të ndërmjetësimit, janë regjistruar 6 (gjashtë) lëndë të ndërmjetësimit sipas raporteve të dërguara për punën e ndërmjetësuesve të licencuar deri te Ministria e Drejtësisë – Sektori për noterë, përmbarues dhe ndërmjetësues.

Në gjashtë rastet e regjistruara të ndërmjetësimit në muajin gusht, në dy lëndë procedura ka përfunduar me arritje të marrëveshjes. Në 4 (katër) lëndët e tjera palët nuk kanë treguar interesim që kontestin ta zgjidhin në mënyrë jashtëgjyqësore përmes ndërmjetësimit.⁷

Ministria e Drejtësisë në gjysmën e dytë të muajit gusht, në faqen e saj të internetit e publikoi listën e ndërmjetësuesve të licencuar të cilët e kanë dhënë provimin për ndërmjetësues dhe të cilëve u është lëshuar licencë për ushtrimin e punëve të ndërmjetësimit konform dispozitave të Ligjit të ri për ndërmjetësim. Lista e ndërmjetësuesve të licencuar, përveç në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë është publikuar edhe në faqen e internetit të Dhomës së Avokatisë së RM, në faqen e internetit të Dhomës Ekonomike të Maqedonisë, si dhe nga ana e disa gjykatave në fletërrufetë e tyre, për çka pa marrë parasysh faktin që brenda kësaj periudhe nuk ka pasur rritje të aktiviteteve, vërehet rritja e interesimit të personave juridikë dhe e avokatëve për informacionet e ndërmjetësimit si procedurë, për mënyrën e zbatimit të procedurës, si më së lehti të zgjidhet ndërmjetësuesi, si ngihet procedura, cilat dokumente i nevojiten ndërmjetësuesit që të veprojnë sipas kërkesës së palës së interesuar dhe ngjashëm.

Gjatë muajit gusht u lëshua në përdorim ueb faqja e re e Qendrës Maqedonase për Ndërmjetësim: www.mcm.org.mk me qëllim të informimit me kohë për ndërmjetësimin dhe për aktivitetet e Qendrës. Qendra Maqedonase e Ndërmjetësimit është organizatë joqeveritare, qëllimi dhe misioni kryesor i së cilës është promovimi dhe praktikimi i ndërmjetësimit në Maqedoni, sigurimi i informacioneve për palët e interesuara për procedurën e ndërmjetësimit, organizimin e trajnimeve dhe punëtorive për t'u njoftuar me procedurën e ndërmjetësimit dhe ngjashëm.

⁷ Të dhëna zyrtare nga Ministria e Drejtësisë

